



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



**Raporti  
mbi trajtimin e ankesave dhe  
sugjerimeve të sipërmarrjes  
për muajin maj 2020**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA**  
**MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES**

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në vijim të komunikimit me ju, në rolin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me qëllim përditësimin tuaj mbi punën e bërë gjatë këtij muaji, lejomëni të ndaj me ju raportin e muajit maj 2020 si dhe trajtimin e ankesave në kuadër të njoftimeve periodike.

Përgjatë muajit maj, kemi vijuar kontaktin e drejtpërdrejtë me shoqatat dhe dhomat e tregtisë në vend, por edhe me biznese individuale, për të kuptuar dhe administruar problematikat e hasura prej tyre, të lidhura me situatën e krijuar nga COVID-19, situatë e cila ka marrë vëmendjen tonë me qëllim tejkalimin e saj në formë sa më të lehtë.

Rrjeti i koordinatorëve të dedikuar për biznesin në çdo institucion, ka ndjekur me dedikim të vecantë ankesat e ardhura nga sipërmarrja dhe së bashku me ta kemi analizuar dhe trajtuar çdo ankese në kohë reale, duke organizuar takime online në baza javore. Në mënyrë më specifike gjatë kësaj periudhe jemi fokusuar te procedurat e ndjekura nga biznesi për të përfituar “pagën e luftes” për punonjësit si dhe procedurat e aplikimit nga biznesi për përfitimin e garancisë sovrane.

Organizuar një takim falë platformave online me të rinj të talentuar në fushën e inovacionit ku diskutuam situatën e shoqërive start-up gjatë pandemisë por edhe mbi aksesin në treg dhe në fonde të ndryshme për sektorin start-up. Ndër të tjera, diskutuam edhe mbi vijimësinë e punës lidhur me projektligjin e start-up, punë e cila konsiston në bashkëpunimin e ngushtë me institucionet respektive por edhe me partnerët e huaj.

Duke shpresuar në vijimin e komunikimit me ju, shpreh bindjen time të thellë se nëpërmjet bashkëpunimit ne mund të përmirësojmë klimën e të bërit biznes në vendin tonë.


Me konsideratën më të lartë,

Eduard Shalsi




## Analiza e Ankesave Maj 2020


### 1. Shperndarja e ankesave në baza javore



### 2. Statusi i ankesave dhe trajtimi i tyre



### 3. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive dhe bashkive



### 4. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive dhe institucioneve të varësisë.

